



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 07, dt. 21.05.2018

MBI MIRATIMIN E MARËVESHJES TË BASHKËPUNIMIT ME BASHKINË KORÇË PËR PROJEKTIN "QENDRA DITORE PËR MOSHËN E TRETË"

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 14 dhe neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit "Për buxhetin e vitit 2018", Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2018, Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 13 date 18.12.2018 "Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2018", me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratojë Marëveshjen e Bashkëpunimit me Bashkinë Korçë për Projektin "Qendra ditore të moshës së tretë"
2. Të miratojë financimin e kontributit të Këshillit të Qarkut në këtë Projekt në vlerë 2 milion lekë sipas preventivit bashkangjitur.
3. Vlera prej 2 milion lekë do të financohet nga të ardhurat e trashëguara të Këshillit të Qarkut të miratuara për këtë qëllim dhe do të xhirohet në llogari të Bashkisë Korçë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik dhe shërbimeve.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Konceptoi L.Pleqi
Juristi Gj. Kristo
Sek.K.Qarkut B. Muço

